

## **NJOFTIM**

### **“Për marrjen me qira të pasurisë nga të tretët për stacionimin e mjeteve të Bashkisë Devoll”**

Në zbatim të Ligjit 7850 dt. 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 801 e në vazhdim, Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Bashkisë Devoll Nr. 03. Datë 14.01.2020 “Për miratimin e marrjes me qira të një pasurie të paluajtshme me sipërfaqe 1600m<sup>2</sup> për stacionimin e mjeteve të Bashkisë Devoll”

Bashkia Devoll njofton hapjen e procedurës për “marrje sipërfaqe me qira për stacionimin e mjeteve të Bashkisë Devoll me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative të saj”

#### **Kriteret, specifikimet e ambientit dhe dokumentacioni që kërkohet nga ofertuesi qiradhënës:**

Bashkia Devoll kërkon të marrë me qira një sipërfaqe të përshtatshme për stacionimin dhe parkimin e mjeteve të saj me këto kriteret dhe specifikime si më poshtë vijon:

- Pasuria duhet të jetë e llojit Truall/ Arë me sipërfaqe rreth 1600m<sup>2</sup> për stacionimin e 23 mjeteve që janë në gjendje pune dhe disa mjeteve të tjera të cilat nuk janë funksionale.
- Pasuria duhet të ndodhet në territorin e qytetit të Bilishtit në një rreze rreth 500 m larg nga Bashkia Devoll.
- Të ketë aksesin e hyrjes/daljes
- Pasuria duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet për parkimin dhe qëndrimin e mjeteve të Bashkisë Devoll.
- Të jetë e rrethuar, dhe e sistemuar ku të përfshihet dhe rrejeti i sistemimit të kanalizimeve dhe ujrave

**Oferta e qiradhënësit duhet të jetë e shoqëruar me:**

- Kërkesa e subjektit/individit për pjesëmarrje në konkurrim;
- Fotokopje e noterizuar e certificates së pronësisë dhe kartelës së pasurisë e cila duhet të jete e tre muajve te fundit.
- Fotokopje e kartës së identitetit të ofertuesit qiradhënës.
- Ekstrakti QKR-së (nqs është subjekt tregtar).
- Oferta e qiradhënësit duhet të specifikojë çmimin mujor të qirasë.
- Të interesuarit (ofertuesit qiradhënës) duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin brenda datës **24.07.2020, pranë zyrës së Protokoll- Arkivës në Bashkinë Devoll.**